



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 03.06.2025

Numër Protokolli: 3787/2025

A.nr.427/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.427/2025, të datës 07.03.2025, të parashtruar nga ankuesi S.K., kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.427/2025, e datës 07.03.2025, e parashtruar nga ankuesi S.K.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil S.K. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), përmes e-mailit të datës 06.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes të datës 12.02.2025 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me kërkesën për kompensim të diferencës së pagës të papaguara për periudhën 01.02.2023 deri më datën 31.01.2024 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. Reference AGJ 2316/24 në rastin KO 79/23 të datës 24.01.2024, ndërsa ankuesi më datë 31.05.2025 është tërhequr nga ankesa me numër protokolli 1480/2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimi të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.427/2025 të datës 07.03.2025.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.427/2025

Atdhe Gashi

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit S.K.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.